



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MINISTRI

8635
Nr.....Prot.

Tiranë më 06/09/2016

URDHËR

Nr. 455, datë 06.09.2016.

PËR
CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT TË VITIT AKADEMIK 2016 - 2017 NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 87 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Viti akademik 2016 - 2017 në institucionet e arsimit të lartë, të fillojë në datën 20 Tetor 2016 dhe të përfundojë në datën 30 Shtator 2017.
2. Periudha 26 Dhjetor 2016 deri në 6 Janar 2017, të jetë periudhë pushimesh për studentët.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

